

**VENDIM**  
**Nr.508, datë 30.7.2004**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E TURIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për bashkëpunim në fushën e turizmit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MOLDAVISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E TURIZMIT**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Moldavisë, më poshtë të quajtura “Palët”,

*nisur nga* dëshira për të zgjeruar më tej marrëdhëniet miqësore ndërmjet dy vendeve mbi baza të barazisë dhe përfitimit të përbashkët,

*duke njohur* rëndësinë e turizmit në zhvillimin e marrëdhënieve të tyre ekonomike dhe për një mirëkuptim më të madh ndërmjet popujve,

ranë dakord për sa vijon:

**Neni 1**

Palët do të ndihmojnë për zhvillimin, si dhe do të forcojnë bashkëpunimin në fushën e turizmit, do të rrisin shkëmbimet turistike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Moldavisë në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi në të dy vendet.

**Neni 2**

Palët do t'i kushtojnë rëndësi të veçantë zhvillimit të turizmit ndërmjet vendeve të tyre përkatëse nëpërmjet një turizmi të organizuar dhe individual, turizmit tematik, kongreseve, simpoziumeve, ekspozitave, festivaleve të teatrove, muzikore dhe aktiviteteve sportive.

**Neni 3**

Bashkëpunimi i përcaktuar në këtë Marrëveshje do të arrihet nëpërmjet veprimeve të mëposhtme:

- krijimit të *jonit ventures* në fushën e turizmit;
- zhvillimit të bashkëpunimit ndërmjet kompanive turistike;
- shkëmbimit të ekspertëve, delegacioneve ose grupeve të ekspertëve në fushën e turizmit;
- organizimit të ekspozitave të përbashkëta, kongreseve, konferencave, simpoziumeve, tavolinave të rrumbullakëta;
- sigurimit të shërbimeve të konsulencës në fushën e shërbimeve hoteliere dhe restoranteve, për përgatitjen dhe për kualifikimin e personelit.

#### Neni 4

Palët do të mbështesin bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, njërive, shoqërive turistike, si dhe organizatave të tjera të autorizuara për zhvillimin e turizmit në vendet e tyre respektive.

#### Neni 5

Palët do të nxisin institucionet e tyre publike dhe private për të shkëmbyer eksperiencën e tyre në fushën e turizmit dhe të statistikave në turizëm, si dhe në atë të publikimeve, shkëmbimin dhe shpërndarjen e materialeve turistike, materialeve promociionale, filma dhe reklama turistike me qëllim rritjen e fluksit të turistëve në vendet e tyre përkatëse.

#### Neni 6

Palët do të nxisin bashkëpunimin në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me përgatitjen e personelit të turizmit, si dhe finalizimin e marrëveshjeve dhe vendosjen e kontakteve ndërmjet organizmave publikë dhe/ose privatë në lidhje me përpilimin e projekteve dhe studimeve turistike.

#### Neni 7

Palët do të përpiqen, nëpërmjet institucioneve të autorizuara, të zhvillojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me çështje të diskutuara nga Organizata Botërore e Turizmit.

#### Neni 8

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të jenë:

- Në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit
- Në Republikën e Moldavisë: Drejtoria e Zhvillimit të Turizmit.

#### Neni 9

Palët do të përpiqen që në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendet e tyre përkatëse të thjeshtësojnë formalitetet e udhëtimit, si dhe procedurat e kontrollit kufitar me qëllim rritjen e fluksit turistik ndërmjet dy vendeve.

#### Neni 10

Palët do të zgjidhin mosmarrëveshje që mund të dalin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, të cilat do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve dhe konsultimeve.

#### Neni 11

Palët, me mirëkuptim, mund ta ndryshojnë këtë Marrëveshje. Këto ndryshime do të përfshihen në protokolle të veçanta dhe do të jenë pjesë përbërëse të Marrëveshjes. Këto protokolle do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 12

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën palët do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të brendshme të parashikuara nga legjislacioni i secilës palë për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për një periudhë 5-vjeçare, e cila do të rinovohet automatikisht për një periudhë të njëjtë kohore nëse asnjëra palë nuk njofton palën tjetër në rrugë diplomatike për qëllimin e saj për të denoncuar Marrëveshjen të paktën 6 muaj përpara afatit të

përfundimit të Marrëveshjes.

Bërë në Chisinau, më 11 qershor 2004, në dy ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe, moldave dhe angleze, të gjithë njësoj të vlefshëm.

Në rast mosmarrëveshjes në lidhje me interpretimin e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.